

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BIO - SKRAPARI” SHPK

Ortaku themelues si më poshtë:

- **Z. Ergis Guri**, lindur ne date 14.02.1977 i shtetësisë dhe kombësisë Shqipëtare, i pajisur me letërnjoftim nr. personal ; H70214215L

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, sot më datë **11.04.2018**, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “**BIO - SKRAPARI**”. Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare , “**BIO - SKRAPARI**” ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**BIO - SKRAPARI**” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Çorovode, Skrapar, Lagjia Pazar i Ri, Rruga Kryesore, godinë 1 kateshe me nr.1420.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt aktiviteti :

Tregtim i mallrave e materialeve të ndryshme, produkteve bujqësore e blektorale. Aktivitete të ndryshme në lidhje me produktet blektorale e bujqësore. Prodhim përpunim produkte bujqësore, blektorale përpunim i mishit, qumështit, thertore, etj. Ndërtim objekte të ndryshme të ulëta e të larta, vila, mirëmbajtje e riparim objekte të ndryshme. Shërbim për mirëmbajtjen dhe riparim të mjeteve motorike të ndryshme. Import eksport të makinerive të ndryshme, produkte bujqësore e blektorale, mallra e materiale të ndryshme etj. Import eksport mjete motorike, pjesë këmbimi, shitblerja e tyre. Import eksport i kafshëve të gjalla për mbarshtrim dhe tregtim, shpendëve etj. Import eksport i pemëve dekorative, natyrale dhe luleve natyrale. Importi dhe eksporti i ushqimeve blektorale dhe i drithrave. Import eksport i lëndës drusore. Shërbim ndërmjetësimi për lidhje kontratash midis firmave vendase e të huaja.

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.



NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare "BIO - SKRAPARI" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë "BIO - SKRAPARI" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "BIO - SKRAPARI" SHPK është 100.000 (Njëqind mijë leke) lekë, i ndarë 1 kuote, me vlerë 100.000 leke secila kuotë.

8.2 Kapitali zotërohet nga ortakët e shoqërisë:

1. **Z. Ergis Guri**, zoteron 1 kuote me vlere 100.000 mijë leke, barabarte me 100%.

NENI 9

Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10

Administratori

Shoqëria administrohet nga një ose me shume administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vite me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë është **Z. Ergis Guri**.

NENI 11

Sekreti tregtar

Ortakët, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë "BIO - SKRAPARI" SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

NENI 12

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës kompetente.

ORTAKU THEMEUES

ERGIS GURI

ERGIS GURI
11.04.18